

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: QENDRA E STUDENTEVE
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 1020890500-24-1280-1-2-1
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: Furnizim dhe instalim me zërim dhe TV në mensën e studentëve

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

EOR GROUP SH.P.K &NB COMPANY SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Deshmoret e Ponoshecit Nr. 101
(Adresa)

Prishtinë 10 0000
(Vendi) (Kodi postar)

049/ 542 333
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

SHPRESA VELIU
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
eor.groupshpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

26.03.2024
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Njoftimi për kontrate i datës **22.02.2024**
2. Dosja e tenderit e datës **04.03.2024**
3. Procesverbali i hapjes i datës **04.03.2024**
4. Njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës **08.03.2024**
5. Letra standarde për tenderues të pasuksesshëm e datës **08.03.2024**
6. Kërkesa për rishqyrtim **13.03.2024**
7. Vendimi i përgjigjes në kërkesën për rishqyrtim nga AK-ja **18.03.2024**

Kriteri për dhenjen e kontratës ishte çmimi me i lirë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input checked="" type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------	--

--

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

<input checked="" type="checkbox"/> Po	<input checked="" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>	
--	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Furnizim dhe instalim me zërim dhe TV në mensën e studentëve** OE EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK dorzon **ANKESË**.

Njoftimi për kontratë është bërë me datën 22.02.2024 ndërsa hapja publike do të bëhet me datë 04.03.2024, ndërsa vendimi është bërë "Njoftimi për Vendimin e AK-së" me datë 08.03.2024.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, kemi bërë kërkesë për rishqyrtim dhe Autoriteti Kontraktues ka kthyer si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim, Grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK të pa kënaqur me vendimin e AK-së rreth shqyrtimit të kërkesës tonë për rishqyrtim dhe shkeljeve të rënda të bëra të dispozitave të LPP-së nga Autoriteti Kontraktues, në afat të rregullt kohorë parashtrijmë ankesë pran OSHP-së.

Vendimin e AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e gjeni të bashkangjitur.

Kërkojmë nga PSH i OSHP që të shqyrtojë ankesën tone dhe të detyrojë Autoritetin Kontraktues që të anulojë vendimin e dates 08.03.2024 duke e respektuar kërkesat e dhëna me FTD të dosjes se tenderit dhe duke u bazuar në dispozitat e LPP-së të dhe kërkesat e FTD-së të dosjes se tenderit të shperblehet me kontratë Grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK, pasi që në bazë të kërkesave të FTD të dosjes se tenderit, OE i shperblyer me kontratë nuk është i përgjegjshëm sispas kushteve dhe kërkesave të dhëna në FTD të dosjes se tenderit. Grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK është i përgjegjshëm dhe i plotsojmë të gjitha kërkesat e dhëna me DT.

Grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK kërkon nga PSH i OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues të anulojë vendimin e datës 08.03.2024 dhe të kthejë lënden në rishqyrtim pasi që vendimi i publikuar me 08.03.2024, nga AK QENDRA E STUDENTEVE, është vendim i marrë në kundërshtim me kërkesat e FTD të dosjes së tenderit dhe nuk janë respektuar: Neni 1- Qëllimi, Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca, Neni 56- Dispozitat e Përgjithëshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale dhe Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë të LPP-së

Në njoftimin për kontratë dhe në FTD të dosjes së tenderit të neni **9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**, me FTD është kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
		Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar projekte të ngjashme në tre vitet e fundit deri në datën e këtij njoftimi, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese të këtyre projekteve.	Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit deri në datën e këtij njoftimi dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbalet e pranimit të furnizimeve shërbimeve.
		Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatat ISO 9001 2015- ISO –27001 2013,ISO – 45001 2018	Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatat ISO 9001 2015- ISO –27001 2013,ISO – 45001 2018

B15_Dosja e Tenderit – Furnizim- Procedur e Hapur

14

Numri i Prokurimit: 1020890500-24-1280-1-2-1 – Titulli Furnizim dhe instalim me zërim dhe TV në mensën e studentëve

		Stafi i operatorit ekonomik Një Inxhinieri i diplomuar i Elektroteknikes (bachelor ose master), diploma CV-ja, minimum 3 vite përvojë pune, pas diplomimit. i cili duhet të jetë i certifikuar në fushën e IT DIPLOMA E NOTERIZUAR. - Një teknik i elektroteknikes i certifikuar në fushën e IT	Stafi i operatorit ekonomik Një Inxhinieri i diplomuar i Elektroteknikes (bachelor ose master), diploma CV-ja, minimum 3 vite përvojë pune, pas diplomimit. i cili duhet të jetë i certifikuar në fushën e IT DIPLOMA E NOTERIZUAR. - Një teknik i elektroteknikes i certifikuar në fushën e IT
--	--	---	---

Pas publikimit të njoftimit nga Autoriteti Kontraktues të vendimin e datës 08.03.2024, Grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK ju kemi drejtuar Autoritetit Kontraktues me kërkesë për rishqyrtim me datën 13.03.2024 dhe Autoriteti Kontraktues me datë 18.03.2024 e ka kthyer përgjigjejen në kërkesë për rishqyrtim: **Refuzohet si e pa bazë**

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelë rëndë dispozitat e LPP-së pasi që nuk ka respektuar Nenet 1,6, 7, 56, 59, 69 dhe 72 të LPP-së si dhe UDHËZUESIN Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK.

AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së dhe jo të shoh ligji në mënyrë selektive andaj bazuar në pretendimet ankimore dhe atë që u përshkrua si me larte kërkojmë që kjo procedure e prokurimit të kthehet në ri vlerësim me qëllim që të trajtohen në mënyrë të drejte kërkesat, kundrejt ofertave sipas dispozitave dhe parimeve të prokurimit publik në fuqi.

Autoriteti Kontraktues edhe pas kërkesës për rishqyrtim ka shkelë rend parimet bazë të LPP-së dhe e ka pare ligjin në mënyrë selective dhe ka shkelur dispozitat:

Neni 1- Qëllimi,
Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca,
Neni 56- Dispozitat e Përgjithëshme mbi Përzgjedhjen e Pjesmarrësve dhe Dhënien e Kontratave,
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve,
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale dhe
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë të LPP-së
UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kërkojmë nga PSH i OSHP që të SHQYRTOJË ANKESËN tone dhe ta detyrojë Autoritetin Kontraktues që anulojë vendimin e datës 08.03.2024, duke e respektuar kërkesat e dhëna me FTD të dosjes së tenderit.

Bazuar në kërkesat e FTD të dosjes së tenderit grupi i OE-ve Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT


SH.P.K.- Dega në Kosovë, i shpërblyer me kontratë nuk është i përgjegjshëm sipas kushteve të dhëna në FTD të dosjes së tenderit.

Te pa kënaqur me njoftimin B58 për shpërblyerimin me kontratë të datës 08.03.2024 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - AK **QENDRA E STUDENTEVE** në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim dhe instalim me zërim dhe TV në mensën e studentëve”** me nr. të prokurimit: **1020890500-24-1280-1-2-1** dhe numër të brendshëm të prokurimit **QS 2024 002 121** në afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ushtrojmë këtë:

ANKESË

Për shkak se AK- **QENDRA E STUDENTEVE**:

Në mënyrë të kundërligjshme e ka shpërblyer me kontratë OE Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë në lidhje me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim dhe instalim me zërim dhe TV në mensën e studentëve” me nr. të prokurimit: 1020890500-24-1280-1-2-1 dhe numër të brendshëm të prokurimit QS 2024 002 121 pasi që nga çasja në dokumente certifikatat e ISO STANDARDEVE janë të dyshimta dhe kemi komunikuar me kompaninë **CertiW** dhe kanë dhënë përgjigje se këto certifikata janë tërhequr:



prandaj besojmë se janë modifikuar “falsifikuar”, prandaj ky grup i OE-ve është i pa përgjegjshëm. Deri sa grupi i OE EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT) dhe kemi ofertuar me Tender të përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**.

Sqarojmë ne mënyrë te detajuar :

Autoriteti Kontraktues **QENDRA E STUDENTEVE** me datën 08.03.2024 ka publikuar njoftimin për kontratë për tenderin: “Furnizim dhe instalim me zërim dhe TV në mensën e studentëve ” me nr. te prokurimit: 1020890500-24-1280-1-2-1 dhe numër te brendshëm te prokurimit QS 2024 002 121 **dhe me datën** 04.03.2024 e kemi dorëzuar tenderin tone ne platformën elektronike te e-prokurimit ku kemi aplikuar për këtë tender , mirpo pas qe AK e publikon njoftimin B58 mbi vendimin e AK-se ku e shperblehet Grup i Operatorëve Ekonomik Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë më këtë tender, grupi i OE EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK ka derguar kërkes për çasje në dokumente të AK-ja, ku AK-ja na dha çasje konform ligjit dhe nuk kemi asnjë vrejtje gjatë çasjes në dokumentacion.

Nga shqyrtimi i dokumenteve kemi vrejtur se ISO Certifikatat e Grupit të Operatorëve Ekonomik Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë kanë elemente dyshuese se janë të ndryshuara data e valeditetit të certifikatave “ të falsifikuara” pasi qe data në vetë dokumentin e Certifikates kanë mos përputhje dhe ky fakt na bënë të dyshojmë se këto dokumete janë modifikuar.

Në vazhdim po e bashkangjesim një Certifikat qe kanë prezantuar Grup i Operatorëve Ekonomik Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë, mirpo kjo është dukur ne të gjitha Certifikatat e keti formati ku i kemi kufizuar me ngjyrë te kuqe ndryshimet dhe mos përputhjet e datave.

Dyshojmë se data të pjesa e faqes se bardhë lehtë është modifikuar dhe ndryshuar mirpo të pjesa e hijezuar me ngjyrë nuk kanë mundë të ndryshohet sepse do të mbeteshin gjurmë, këtë datë vetem Kompania qe i pajis me certifikata ka mundësi të ndryshojë dhe saktsonë deri kur është valide Certifikata.



Certificato di Registrazione Certificate of Registration

Il presente documento attesta che il sistema di gestione di /
This is to certify that the management system of

IMPACT SH.P.K

**Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Komuna e Parisit, pallati nr.4, dyqani nr.2,
TIRANE, ALBANIA**

è conforme ai requisiti / is complied with the requirements of standard

ISO 9001:2015

per il seguente scopo / for the following scope:

**COMMERCIALIZZAZIONE, INSTALLAZIONE E MANUTENZIONE DI TELECAMERE, SISTEMI
DI ALLARME, RILEVAZIONE INCENDIO E COMPONENTI ELETTRONICI IN GENERE.**

**TRADE, INSTALLATION AND MAINTENANCE OF CAMERAS, ALARM SYSTEMS, FIRE
DETECTION AND ELECTRONIC COMPONENTS IN GENERAL.**

Certificato N.
Certificate No.

SB.19.0026.00.QMS

Codice di Documento/Document code:
F08.21 V7 - 15 Sep 2021

Data di prima emissione: Originally registered:	Data di ultima emissione: Latest issue:	Data di scadenza: Expiry date:
28.02.2019	15.02.2022	27.02.2023



Dyshojme se data është ndaluar pasi qe me poshte
shkruan nga sotë data e skadencës është 27.02.2023


George Soguer

La validità del presente certificato è subordinato ad un esito positivo del
continuing assessment e del pagamento dei relativi importi annuali.
Ad oggi la data di scadenza è: 27.02.2023.
The validity of this certificate is subject to a successful outcome of the
continuing assessment and to the payment of related annual fees.
To date the expiry date is: 27.02.2023.

Per conto ed in nome di Certi W ®
For and on behalf of Certi W ®

This certificate was issued electronically and remains the property of Certi W Baltic Ltd and is bound by the conditions of contract.
Printed copy can be validated on request. To verify the authenticity send an e-mail to info@certi.w.com or scan the QR Code.
© Copyright 2008 - 2022 - Certi W ® is a registered trademark owned by Certi W International Ltd.
SIA "Certi W Baltic" Headquarter: Aspatijas bulvaris, 20, LV-1050 - Riga - Latvia

Në vazhdim po bashkangjesim të njejtën ISO Certifikat të përkthyer me googel translate dhe mundë të vertetoni faktin e paraqitur se datat nuk përputhën: Të pjesa e hijzuar nga Kompania e cila e ka lëshuar Certifikatën ISO shënon: Nga sot data e skadencës është 27.02.2023. Pra pas kësaj date ky dokument nuk vlenë.



Pra thënë shkurt vendimin i AK-se ku e shperblehet Grup i Operatorëve Ekonomik Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë më këtë tender, ky vendim i AK është i kundërligjshëm pasi qe dokumentet e prezantuara të Grup i Operatorëve Ekonomik Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë janë të “Falsifikuara” dhe Grup i Operatorëve Ekonomik Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë është i papërgjegjshëm .

Me dashje apo pa dashje AK-ja ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Si dhe ne piken 2 thuhet : *Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.*

AK për këtë aktivitet të prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë: *Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët,*

AK në mënyrë të kundërligjshme e ka shpërblyer Grupin e Operatorëve Ekonomikë Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë.

Deri sa kemi marrë përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim kemi besuar se AK-ja ka qenë e lajthituar nga grupi i OE-ve Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë, mirpo pas pranimit të vendimit të kërkesës për rishqyrtim kur shkel rëndë dispozitat e LPP-së dhe favorizon kundër ligjëshëm këtë grup të OE-ve, lindë dyshimi të AK-ja se ka interesa të individve apo grupi të individve duke shkelur dispozitat e LPP-së dhe po e favorizon një grup të OE-ve, pyetja:

Cila është arsyeja e Favorizimit të këtij grupi të OE-ve nga AK-ja, kur ky grup ka bashkangjitur dokumente të falsifikuara me dosje të tenderit si dhe në përgjigjen e dhënë me Letren standarde për informata sqaruese të datës: **07.03.2024?**

Pasi që AK-ja gjatë vlersimit të ofertave para publikimit të njoftimit të vendimit të datës 08.03.2024 i ka dërguar Letër standarde për informata sqaruese grupit të OE-ve Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë:

Dëshmi

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

QENDRA E STUDENTEVE, AGIM RAMADANI P.N. - PRISHTINË

[Grup i Operatorëve Ekonomik Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë] 07.03.2024

Nr. i prokurimit:	1020890500-24-1280-1-2-1
Nr i brendshëm	QS 2024 002 121

Titulli: Furnizim dhe instalim me zërim dhe TV në mensën e studentëve

Ue nderuar(a) [Z.Zn] [Grup i Operatorëve Ekonomik Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguron sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

1. Bazuar në njoftimin për kontratë, nën **III.2.4 – Kapaciteti teknik dhe profesional, Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatat ISO 9001:2015, ISO –27001 –2013,ISO – 45001 – 2018, ndaj sipas kësaj listëri kërkojme sqarime nga ju pasi që certifikatat e kërkuara duhet të jenë valide dhe të jenë të kompletuara (3 certifikata).**

Përgjigja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh me shkrim, në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues ose në numrin e faks-it [shëno numrin e faks-it] apo në e-mailit [skender.lepaja@rks-gov.net] brenda [3] ditëve nga data e kësaj kërkeje.

Pa përgjigjen nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht,

Me respekt,

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

[Nënshkrimi]

Dhe grupi i OE-ve Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë kanë bashkangjitur me oferte si dhe në përgjigjen e parë ne letren standard të dates 07.03.2024 te derguar nga AK-ja, certifikatat e leshuar nga kompanija Certiw

Name	Size	Packed	Type	Modified	CRC32
...			File folder		
Certificate_Impact_22301_AI.pdf	2,799,408	2,357,159	Adobe Acrobat Do...	6/16/2022 12:2...	EC2AF51F
ISO 9001.pdf	448,115	347,856	Adobe Acrobat Do...	6/16/2022 12:2...	9B89507D
ISO 14001.pdf	450,984	350,431	Adobe Acrobat Do...	6/16/2022 12:2...	D7D7629D
ISO 20000.pdf	444,049	342,924	Adobe Acrobat Do...	6/16/2022 12:2...	2458875C
ISO 27001.pdf	457,174	356,479	Adobe Acrobat Do...	6/16/2022 12:2...	B7870C94
ISO 45001.pdf	453,708	352,434	Adobe Acrobat Do...	6/16/2022 12:2...	51044789

Kur happen certifikatat janë këto certifikata, paraqitet certifikatat në vazhdim në të cilat dokumente është ndryshuar data e skandencës nga **22.03.2023** dhe është ndryshuar në date **27.02.2025**.

Pasi qe grupi I OE-ve ka ngarkuar me ofertë dhe pas dergimit të letres standard për informata sqaruese nga AK-ja dy here radhazi këto certifikata të lëshuara nga nga kompania Certiw me date të modifikuar kjo tregon se nuk është ngarkuar gabimisht certifikata po është falsifikuar dhe në momentin qe e kemi vertetuar se kjo certifikat është e falsifikuar dhe i kemi derguar kërkesen për rishqyrtim AK-ja është dashtë të anuloi njoftimin e vendimit të dates 08.03.2024 dhe të merr masa konform dispozitave të LPP-së ndaj grupit të OE-ve Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë.

AK-ja ka shkelur dispozitat e LPP-së kur e pranon një document të ri nga grupi I OE-ve Cimi @

ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë I lëshuar nga një kompani tjetër ku sipas LPP-së dokumentet ekzistuese nuk mundë të ndryshohen

Edhe pas prezantimit të gjitha fakteve me kërkesen për rishqyrtim se grupi i OE-ve Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë është I pa përgjegjshëm dhe ka bashkangjitur dokumente të "falsifikuara", AK-ja e refuzon si të pa bazuar kërkesen për rishqyrtim dhe çuditrisht vendos të vazhdoj aktivitetin :

FAKTI 1:

Certifikatat e dorzuara nga grupi I OE-ve Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë me ofertë dhe pas dërgimit të letres standard për informata shtesë të dates 07.03.2024.




Bazuar në Nenin 72 të LPP-së, OE nuk ka të drejtë të ndryshojë dokumentet të cilat janë dorzuar me ofertë.

Mirpo fakti qe e kemi kuptuar se certifikatat janë të falsifikuara grupi i OE-ve Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë në bashkpunim me AK-në në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së AK-ja pranon që grupi i OE të ndryshojë dokumentet në kundërshtim me dispozitat e LPP-

së dhe UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe kundërligjësëm e shpallë fitues: grupin e OE-ve Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë.

Vie pytja: Në qoftë se certifikatat qenkan ngarkuar dy here (me ofertë dhe pas letres standarde për informata sqaruese te derguar nga AK-ja) pse këtyre certifikatave ju është ndryshuar data e valeditetit nga 22.03.2023 kur ka skaduar në datën e manipuluar 27.02.2025?

Si ka mundësi të ngarkohen gabimisht edhe me ofertë edhe me letren standarde për informata sqaruese të dates 07.03.2024?



Pasi qe grupi i OE-ve Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë dhe AK-ja e kanë kuptuar se këto dokumente e kemi kuptuar se janë të falsifikuara në bashkëveprim me AK-në kanë bërë shkelje të rënd të dispozitave të LPP-së dhe një herit konsiderojmë se është edhe veper penale në bashkëkryerje, pasi qe ne kete rast kur AK-ja eshte informuar se certifikata ISO eshte e modifikuar “Falsifikuar” data kinse ka afat te validitetit eshte dasht te merr masa konform dispozitave te LPP-së ndaj grupit të OE-ve Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.; IMPACT SH.P.K.- Dega në Kosovë e jo të shperblehet me kontratë.

Pra grupi i OE-ve EOR GROUP SH.P.K &NB COMPANY SHPK kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit dhe oferta jone është Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët**.

Besojmë se i kemi elaboruar dhe prezantuar fakte me se të mjaftueshme, me shume se sa që duhet dhe shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Kërkojmë nga PSH i OSHP-së të detyrojë AK-në që ti respektoj në përpikëri dispozitat ligjore që janë në fuqi lidhur me këtë lloj të aktivitetit të prokurimit dhe të nxjerr:

Bazuar në faktet e prezantuara kërkojmë nga PSH i OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues të anuloi **vendimin e datës 08.03.2024** dhe të kthejë lëndën në rishqyrtim ku do të shpallë vendimin e ri, ku do të **shperblejë me kontratë grupin e OE-ve EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK**, pasi që jemi OE e përgjegjësme me çmimin me të lirë.

Grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK është i përgjegjës dhe në pajtushmeri me të gjitha kërkesat e dhëna me njoftimin për kontratë dhe FTD të dosjes të tenderit si dhe ka ofertuar me çmimin me të lirë.

Kërkojmë nga PSH i OSHP-së të detyrojë Autoriteti Kontraktues të anuloi vendimin e datës 08.03.2024 dhe të kthejë lëndën në rivlersim, që të merr:

VENDIM

APROVOHET e bazuar kërkesa për rishqyrtim e grupit të OE-ve EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK lidhur me tenderin Furnizim dhe instalim me zërim dhe TV në mensën e studentëve i iniciuar nga QENDRA E STUDENTEVE.

TË ANULOHE vendimi i Autoritetit Kontraktues QENDRA E STUDENTEVE për Njoftimin mbi Vendimin e AK e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar në kërkesat e FTD të dosjes së tenderit dhe të shpallet njoftimi i ri që fitues të shpallë **grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK**.

Bazuar në shkeljet e lartë cekura dhe faktet që posedojmë, ne do të vazhdojmë me procedurat ligjore, në të gjitha instancat që parashihen me ligj në Republikën e Kosovës.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Mos respektimi i dispozitave të LPP-së na krijon dëme të konsiderueshme materiale, gjithaë ashtu na humbë kredibilitetin dhe seriozitetin në punë të gjitha këto kanë kosto dhe marrin kohë për sigurimin e tyre.

Shkelja e supozuar ka ndodhur nga Autoriteti Kontraktues dhe ka shkelur pa dashje apo me dashje dispozitat e LPP-së (Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës) pasi që ne kemi plotsuar të gjitha kërkesat e dhëna me Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e Tenderit, deri sa Autoriteti Kontraktues shperblen me kontratë një grup të OE-ve të pa përgjegjshëm dhe certifikatat ISO të bashkangjitura me ofërë të falsifikuara, pra me këtë rast konsiderojmë se po e favorizon këtë grup të OE-ve i cili është i pa përgjegjshëm, duke prezantuar dokumente të dyshimta për nga përmbajtja dhe një herit është i pa përgjegjshëm.

Shkaktimi i dëmit në këtë rast do të jetë përtej dëmit të fitimit të humbur.

Në qoftë se nuk shpallemi fitues bazuar faktet e prezantuara me lartë, Grupi i Operatorve EOR GROUP SH.P.K & NB COMPANY SHPK do të vazhdojmë kërkesën e të drejtave tona në të gjitha instancat e Republikës së Kosovës. Autoriteti Kontraktues ka sjellë vendim në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, RROUPP dhe ligjet tjera të Republikës së Kosovës.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*